

Miratimi i Informuar

NDËRMJET PËRFITUESIT DHE PSIKOLOGUT NË SHMFF

NISMA PËR NDRYSHIM SHOQËROR ARSIS PËR SHMFF BASHKIA KORÇË

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe Bashkisë Korçë , e lidhur me datë 13.07.2021 me nr.prot 6013 dhe nr.101 prot,(NISMA) dt.15.07.2021 për zbatimin e projektit *“Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)* me mbështetje të Fondit Social (2021-2023), ekipi i Nisma ARSIS ka hartuar një dokument mbi Miratimin e Informuar gjatë zhvillimit të seancave të këshillimit psikologjik me të miturit/rriturit.

Hartimi i dokumentit bazohet në nenin 4 të marrëveshjes dhe në zbatim të aktivitetit *“Hartimi i të gjitha politikave të mbrojtjes së klientëve (përfituesve) dhe punonjësve të shërbimit.”*



BASHKIA KORÇË

Miratimi i informuar është thelbësor për etikën që SHMFF ndjek në trajtimin e rasteve. Rastet kanë të drejtën për të marrë informacion dhe për të bërë pyetje rreth shërbimeve që do tu ofrohen dhe si do të bëhen pjesë e këtyre shërbimeve, në mënyrë që të gjitha vendimet e marra të jenë të dakordësuara prej tyre.

Miratimi i Informuar

Sot, më datë _____, është nëshkruar miratimi i informuar ndërmjet palëve:

I. **Shërbimet Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen Bashkia Korçë**, Nr tel _____, përfaqësuar nga përgjegjësjja e shërbimit Znj. _____ dhe Psikologe Znj. _____

II. Z/Znj. _____, i biri/e bija i/e _____ dhe _____, lindur në _____, më datë _____, me shtetësi shqiptare, mbajtës/e e letërnjoftimit me nr. _____, këtej e tutje e quajtur shkurtimisht **“Përfituesi”**.

Miratimi i informuar hartohet dhe nëshkruhet në kuadër të parimit të konfidencialitetit (sigurisë) së informacionit që ju apo fëmija juaj/në kujdestarinë tuaj ndani në seancat e këshillimit psikologjik. Seancat që do të zhvillohen mes psikologut/es së Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen, në Bashkinë Korçë, dhe përfituesit janë konfidenciale.

Kohëzgjatja e çdo seanc individuale për fëmijë apo të rritur është *50 minuta*. Orari dakordësohet paraprakisht mes përfituesit/es dhe psikologes që trajton rastin.

Marrëdhënia që psikologu/ja ruan me përfituesin/en është tërësisht profesionale dhe duhet të ruhet e tillë në mënyrë që procesi i këshillimit psikologjik të mos dëmtohet.

Çdo shënim apo vlerësim i psikologut do të mbahet i sigurtë dhe konfidencial nga psikologu/ja dhe informacioni që ju do të jepni gjatë seancave të këshillimit psikologjik nuk do të ndahet me palë të treta.

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Përrjashtim për ndarjen e informacioneve që ju do të jepni dhe të cilat mund të ndahen me palë të treta janë situatat e mëposhtme:

1. Nëse fëmija apo individë të tjerë abuzohen apo janë në rrezik abuzimi;
2. Nëse kanë ndodhur akte kriminale të cilat çënojnë seriozisht mirëqënien e përfituesit/es dhe apo anëtarëve të tjerë të familjes;
3. Nëse fëmijë/individë raportojnë të abuzohen apo të abuzojnë seksualisht;
4. Nëse ka tentativa vetëvrasjeje apo urgjenca mjekësore për të cilat nevojitet ndërhyrje e menjëhershme mjekësore;
5. Çdo situatë tjetër ku psikologu/ja vlerëson se informacioni duhet të ndahet me të tjerët për qëllime të sigurisë së përfituesit/es.
6. Nëse individë nuk është në gjendje të japë leje (ose të refuzojë lejen) për testim ose trajtim. Ju keni të drejtë që të ndërprisni seancat e këshillimit psikologjik në çdo moment që nuk dëshironi të vijoni me to. Gjithashtu, ju keni të drejtë të ruani informacione dhe të mos i ndani ato me psikologun/en pa dëshirë dhe në mënyrë të sforcuar.

Lutemi që pasi të kenë lexuar këtë dokument, të nënshkruani që:

- Keni lexuar dhe keni kuptuar Miratimin e Informuar të plotë.
- Keni kuptuar ruajtjen e konfidencialitetit dhe nevojat të cilat mund ta thyejnë atë.
- Keni kuptuar se ju mund ta ndërprisni marrjen e këtij shërbimi në çdo moment pasi të informoni psikologun/en.
- Pranoni të nisni procesin e këshillimit psikologjik.

Përfituesi/ja

SHMFF, Bashkia Korçë

Z/Znj. _____

Z/Znj. _____

Vetëm për përfituesit nën moshën 18 vjeç

Nëse prindi apo kujdestari nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të firmosë këtë dokument, duhet të bashkëngjitet dokumentacioni i nevojshëm që shpjegon se përse nuk është përfshirë miratimi i prindit apo kujdestarit/es ligjor/e.

Prindi / Kujdestari/ja i/e Përfituesit/es

Emër Mbiemër

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Lidhja me Përfituesin/en

Firma

Data

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*)

Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS